



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada -Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije, Rad i Transfere – Ministry of Finance, Labour and Transfer

Agjencia Qendrore e Prokurimit / Centralma Agencija Nabavke/Central Procurment Agency

**RAPORT VJETOR I PUNËS I AGJENCISË QENDRORE TË
PROKURIMIT**

PËR VITIN 2022

Përmbledhje Ekzekutive

Në përputhje me detyrimin ligjor, Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) përgatitë dhe i dorëzon ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve një raport vjetor, që pasqyron aktivitetet e prokurimit publik të udhëhequra nga AQP-ja për atë vit kalendarik. Raporti Vjetor për vitin 2022 i përshkruan aktivitetet e AQP-së në vitin paraprak dhe informon institucionet përkatëse, operatorët ekonomikë dhe të gjithë akterët profesionistë rreth funksionimit të AQP-së. Organizimi i brendshëm dhe funksionimi i AQP-së janë përcaktuar me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.

AQP administrohet nga një drejtor i emëruar për një periudhë tre (3) vjeçare. Drejtori udhëheq, organizon dhe drejton punën dhe veprimtarinë e AQP-se dhe është përgjegjës për punën profesionale të AQP-se.

Fushëveprimi i AQP-së, konform Ligjit për Prokurimin Publik, trajton dy (2) lloje kryesore të procedurave të prokurimit:

1. Kontratat e Centralizuara – AQP udhëheq aktivitetet në emër të të gjitha Autoriteteve Kontraktuese; dhe
2. Kontratat e veçanta – AQP udhëheq aktivitete për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës.

Në kuadër të **kontratave të centralizuara në vitin 2022** gjatë vitit 2022 DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura në Vendimin e Qeverisë me nr. 06/27 të datës 30.04.2022. AQP gjatë vitit 2022 ka iniciuar 6 (gjashtë) aktivitete, kurse për artikujt tjerë në listë AQP ka kontrata në fuqi dhe janë duke u implementuar nga AK.

Nga aktivitetet e prokuruar nga DPC janë nënshkruar shtatëmbëdhjetë (17) kontrata me vlerë **25,498,776.91 €**. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte **28,928,603.44 €**, ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **3,429,826.53 €**.

Në kuadër të kontratave të veçanta në vitin 2022, AQP ka iniciuar **63 (gjashtëdhjetë e tre)** aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar **73 (shtatëdhjetë e tre)** kontrata në vlerë totale prej **947,704.41 €**. Vlera e parashikuar për këto 73 kontratat ishte **1,086,432.27 €**. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **138,727.86 €**, që i bie rreth **12.76%**.

Të gjitha dokumentet e prokurimit të AQP-së publikohen rregullisht në përputhje me dispozitat ligjore të transparencës dhe me qëllim të promovimit të veprimtarive brenda komunitetit të biznesit, autoriteteve kontraktuese dhe publikut të gjerë.

AQP gjatë vitit 2022 ka pasur gjithsej 85 kontrata aktive, duke përfshirë kontratat që kanë qenë aktive gjatë tërë vitit, kontratat që kanë skaduar gjatë vitit 2022 dhe kontratat e nënshkruara në vitin 2022. Këto kontrata tregojnë që AQP ka pambushur në plotni vendimin e Qeverisë për procedurat e centralizuara.

Me anë të kontratave të centralizuara është arritur një sukses i dukshëm në kursimin e kohës dhe punës të punonjësve të institucioneve publike dhe operatoreve ekonomikë dhe në uljen e numrit të procedurave të prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Lista e shkurtesave

AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit

AK – Autoritet Kontraktues

DFSHP - Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

DPC – Drejtorati i prokurimeve te centralizuara

DPV - Drejtorati i prokurimeve te veçanta

IKAP – Instituti i Kosovës për Administratë Publike

KRPP – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LPP – Ligji i prokurimit publik

OE – Operator Ekonomik

MF – Ministria e Financave

RUOPP - Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te prokurimit Publik

UA – Udhëzimi Administrativ

Përmbledhja

1. Korniza ligjore	5
2. Struktura organizative	6
2.1 DPC Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC).....	6
2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV).....	7
2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).....	7
3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara.....	8
4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta.....	11
5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	13
6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së	14
7. Trajnimi	14
8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së & Rekomandimet	14
Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE	16
Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV	17
Aneksi 3. LISTA E KONTRATAVE TE CENRALIZUARA NE FUQI.....	23
Aneksi 4. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME	26

1. Korniza ligjore

Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) është agjenci ekzekutive që funksionon në kuadër të Ministrisë së Financave (MF).

AQP është Autoritet Publik dhe Organizatë Buxhetore në kuadër të MF dhe i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë çështjet administrative. Në bazë të Ligjit mbi Prokurimin Publik (LPP) në Kosovë Nr. 04/L-042, neni 95, *i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 (LPP)*, AQP ka përgjegjësinë:

- Me aprovimin paraprak të Ministrit të Financave, AQP mund të kryej në emër të një Autoriteti Kontraktues (AK) një apo me shumë aktivitete të prokurimit me qëllim të ekonomizimit të shpenzimeve (neni 95 paragrafi 1 i LPP)
- Qeveria sipas propozimit të Ministrit të Financave përpilon një listë të mallrave apo artikujve të përdorimit të përbashkët, miratohet në formën e një udhëzimi administrativ. Lista e tillë dhe çdo ndryshim i bërë në të do të publikohet në media dhe të shpallet në faqen e internetit të KRRPP-së (neni 95 paragrafi 2 i LPP). AQP pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët, zhvillon aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara në emër të AK në nivel qendror dhe AK në nivel lokal.
- Me aprovim paraprak, mundë të udhëheq në emër të një AK një aktivitet prokurimi (neni 95 paragrafi 4).
- Një AK mund të kërkojë nga AQP-ja që ta ndihmojë AK në fjalë në kryerjen e një aktiviteti të prokurimit (neni 95 paragrafi 4)
- Gjithashtu, kryen procedurat e prokurimit për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës (neni 21/A paragrafi 2 i LPP-se).

Te gjitha kontrata e nënshkruara nga AQP janë obligative për AK.

AQP është përgjegjëse për kryerjen e procedurave të prokurimit deri në nënshkrim të kontratës, ndërsa menaxhimi i kontratës bëhet nga AK të cilat i shfrytëzojnë këto kontrata. Të gjitha obligimet monetare që rrjedhin për këto kontrata do t'i paguajnë AK nga kodet e tyre buxhetore.

2. Struktura organizative

Agjencia Qendrore e Prokurimit përbehet nga tri drejtorate: Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC); Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) dhe Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFShP), shih Aneksin # 1.

Vlen të theksohet se sipas Ligjit Nr. 06 L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura, si dhe Ligjit Nr.06 L-114 për zyrtarët publik, Drejtoritë shndërrohen në Departamente.

2.1 DPC Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC)

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC) udhëheqë aktivitetet e centralizuara për AK ne nivel qendror dhe ne nivel lokal;

Përfitimet e mundshme të prokurimeve të centralizuara:

- Me prokurime të centralizuara sigurohen çmime më të mira për shkak të ekonomisë së shkallës përmes blerjes me shumicë;
- Specifikimet e standardizuara për mallra dhe shërbime shpijnë në mallra apo shërbime me kualitative;
- Mundësia e situatave të mundshme të 'konfliktit të interesit' zvogëlohet përmes ndarjes së agjencisë kontraktuese dhe kontraktuesve;
- Puna e përbashkët, nga AQP-ja dhe Njësitë Kërkuese, në hartimin e specifikimeve teknike dhe pjesëmarrjen në procesin e tenderimit rrit kompetencat e personelit të Njësisë Kërkuese në fusha të veçanta të prokurimit publik;
- Procedurat e ankesave do të modernizohen për shkak se ka vetëm një operator ekonomik që bën një ankesë kundër dhënies së kontratës kornizë në krahasim me numrin e madh të të mundshme nga një formë e decentralizuar e prokurimit.

DPC ka të punësuar 6 punëtorë dhe ka këtë strukturë:



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2022 ishte rreth **45,000 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

2.2 DPC Drejtorati për Prokurime të Veçanta(DPV)

Drejtorati për Prokurime të Veçanta (DPV) udhëheq aktivitetet e prokurimit për Agjencitë e pavarura DPV ka të punësuar 5 punëtorë dhe ka këtë strukturë:



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2022 ishte rreth **40,000 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

2.3 DPC Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP).

DFSHP ka të punësuar 5 punëtorë dhe ka këtë strukturë:

Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme:

Përkthyesja e gjuhës serbe;

Zyrtarja e lartë e personelit;

Zyrtarja ligjore;

Zyrtar i logjistikës.



Kostoja e kësaj Drejtorie në vitin 2022 ishte rreth **30,000 €** bruto për të gjithë zyrtarët.

3. Drejtorati për Prokurime të Centralizuara

Drejtorati për Prokurime të Centralizuara (DPC), konform nenit 95, pika 2 të LPP-se dhe Vendimit të Qeverisë¹ nr. 15/27 të datës 09.03.2022, vendim i cili ndryshon listën e mallrave ose artikujve të përdorimit të përbashkët, respektivisht Udhëzimin Administrativ QRK-Nr.06/2018 për zbatimin e Prokurimeve Qendrore të Prokurimit Publik, pas miratimit të listës së artikujve të përdorimit të përbashkët nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2022, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit për procedurat e centralizuara të miratuara në këtë Vendim.

Kryerja e procedurave të centralizuara është bere në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë dhe Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria për listën e artikujve të përdorimit të përbashkët.

Ne Vendimin nr.15/27, lista e artikujve përbehej nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) aktivitete ne nivel qendror dhe atë lokal.

Nr.	Lista e artikujve sipas Udhëzimit Administrativ QRK-Nr.06/2018 për Zbatimin e Prokurimeve Qendrore te Prokurimit Publik	Lista e artikujve sipas Vendimit te Qeverise nr.15/27 të datës 09.03.2022
1	Furnizimi me karburante (benzin, diesel)	Furnizimi me letër për kopje
2	Furnizimi me mazut	Furnizimi me material zyrtar
3	Furnizimi me letër për fotokopje dhe printim	Furnizimi me goma për automjete
4	Furnizimi me material zyrtar	Furnizimi me vetura të udhëtarëve
5	Furnizimi me goma për automjete	Furnizim me artikuj ushqimor
6	Furnizimi me bileta të aeroplanit	Furnizim me mobilje
7	Furnizimi me vetura të udhëtarëve	Furnizim me pajisje të TI-së
8	Furnizim me artikuj ushqimor	Furnizim me pemë dhe perime
9	Furnizim me mobilie	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve
10	Furnizimi me ujë të pijes	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira
11	Furnizim me pajisje të TI-së	Furnizimi me karburante
12	Furnizim me pemë dhe perime	Furnizimi me mazut
13	Marrja me qira e veturave të udhëtarëve	Shërbime të transportit ajror
14	Shërbime fotokopjimi, skanimi dhe printimi – me qira	Furnizimi me ujë të pijes
15		Shërbimet e transportit
16		Shërbimet e sigurimit të auto përgjegjësisë

¹ <https://agp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-s%C3%AB-Kosoves-nr.15-67-p%C3%ABr-procedurat-e-centralizuara-per-vitin-2022.pdf>

Gjate vitit 2022 DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për aktivitetet e cekura ne Vendimin e Qeverise me nr. 06/27 të datës 30.04.2022 të publikuar në web faqen e AQP-së, KRPP-së dhe Qeverisë. Bazuar në vendimin e Qeverise, DPC ka zhvilluar procedurat e prokurimit për të gjitha aktivitetet e cekura duke hequr ato për të cilat AQP ka kontrata aktive (ne implementim e sipër) në vitin 2022 nga vitet paraprake.

AQP gjate vitit 2022 ka iniciuar 6 (gjashtë) aktivitete, kurse për artikujt tjerë ne listë AQP ka kontrata ne fuqi dhe janë duke u implementuar nga AK.

Procedurat e zhvilluara nga DPC gjatë vitit 2022 janë: Shërbime të transportit ajror; Furnizim me karburante për Nivelin Qendror dhe për Rajonin e Gjilanit; Furnizim me goma; Furnizim me Mazut; Furnizim me letër për kopje dhe Furnizim me artikuj ushqimor. Ne mënyrë qe t'iu epet mundësia te gjithë OE për te konkurruar, dhe si rrjedhoje te rritet konkurrenca, AQP ne te gjitha rastet ka përdorur procedurën e hapur. Kriteri i shpërblimit i përdorur në këto aktivitetet është kriteri "Tenderi i përgjegjshme me çmimin me te ulet". Po ashtu në mënyrë që të rritet konkurrenca procedura Furnizim me karburante për Nivelin Qendror ka qenë e ndarë në katër (4) Lote, ku është arritur që të nënshkruhen katër (4) kontrata. Kurse Po ashtu procedura për furnizim me artikuj ushqimor aktiviteti ka qenë i ndarë në pesë (5) Lote ku është arritur që të nënshkruhen pesë (5) kontrata si është nënshkruar kontratë edhe për Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Nivelin Qendror – Ritender, si lloj i artikujve ushqimor.

Nga aktivitetet e prokuruar nga DPC janë nënshkruar shtatëmbëdhjetë (17) kontrata me vlerë **25,498,776.91 €**. Vlera e parashikuar e këtyre kontratave ishte **28,928,603.44 €**, ndryshimi/kursimet e mundshme ne mes te vlerës se parashikuar dhe vlerës totale te kontratës janë **3,429,826.53 €**.

Tabela e mëposhtme jep detaje të përmbledhura të kontratave të lidhura nga DPC:

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar</i>	<i>Vlera e kontraktuar</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-22-3398-1-1-1	Lot 1 - Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës	19.07.2022	€ 5,242,396.80	€ 5,118,165.66	€ 124,231.14
2	UA/2016-22-3398-1-1-1	Lot 2 - Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror	29.07.2022	€ 3,387,834.00	€ 3,332,717.33	€ 55,116.67
3	UA/2016-22-3398-1-1-1	Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje gjenerator për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror	29.07.2022	€ 3,094,800.00	€ 2,976,473.58	€ 118,326.42
4	UA/2016-22-5365-1-1-1	FURNIZIMI ME GOMA DIMËRORE PËR AUTOMJETE	12.08.2022	€ 495,000.00	€ 363,377.80	€ 131,622.20

² <https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/05/Udhezimi-Administrativ-per-Prokurime-Qendrore-2020.pdf>

5	UA/2016-22-7727-1-1-1	Furnizim me karburante – Nivel Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së - Ritender	29.08.2022	€ 1,657,142.44	€ 1,625,530.24	€ 31,612.20
6	UA/2016-22-3280-1-1-1	Furnizim me letër për kopje	16.09.2022.	€ 1,100,000.00	€ 986,161.00	€ 113,839.00
7	UA/2016-22-8948-2-1-1	Shërbime të Transportit Ajror - Ritender	23.09.2022	€ 1,625,000.00	€ 1,620,000.00	€ 5,000.00
8	UA/2016-22-7864-1-1-1	Furnizim me MAZUT Nivel Qendror dhe Lokal Ri-Tender	28.09.2022	€ 825,670.20	€ 824,835.94	€ 834.26
9	UA/2016-22-9229-1-1-1	Furnizim me ujë të pijes	10.10.2022	€ 250,000.00	€ 236,450.00	€ 13,550.00
10	UA/2016-22-8802-1-1-1	Furnizim me karburante për Rajonin e Gjilanit - Nivel Lokal	03.11.2022	€ 891,760.00	€ 891,135.06	€ 624.94
11	UA/2016-22-11226-1-2-1	FURNIZIMI ME GOMA PËR AUTOMJETE - NIVELI QENDROR	08.11.2022	€ 99,000.00	€ 86,596.00	€ 12,404.00
12	UA/2016-22-10949-1-1-1	Lot 1 - Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit	15.12.2022	€ 1,940,000.00	€ 1,291,725.00	€ 648,275.00
13	UA/2016-22-10949-1-1-1	Lot 2 - Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës	15.12.2022	€ 1,170,000.00	€ 480,400.00	€ 689,600.00
14	UA/2016-22-10949-1-1-1	Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit	09.12.2022	€ 1,050,000.00	€ 941,300.00	€ 108,700.00
15	UA/2016-22-10949-1-1-1	Lot 4 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	13.12.2022	€ 2,700,000.00	€ 1,986,283.80	€ 713,716.20
16	UA/2016-22-10949-1-1-1	Lot 5 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor	09.12.2022	€ 2,530,000.00	€ 1,890,225.50	€ 639,774.50
17	UA/2016-22-11972-1-1-1	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Nivel Qendror - Ritender	30.11.2022	€ 870,000.00	€ 847,400.00	€ 22,600.00
			Total:	€28,928,603.44	€25,498,776.91	€3,429,826.53

AQP-DPC gjatë vitit 2022 ka operuar me **85 kontrata** duke përfshirë këtu edhe 26 marrëveshjet kornizë me disa Operatore ekonomik për “Furnizim me pajisje te teknologjisë informative” me 16 OE dhe “Furnizim me pemë dhe perime” me 10 OE. Të gjitha kontratat aktive janë të paraqitura në **Aneksin 3**. Këto kontrata tregojnë që AQP ka pambushur vendimet e Qeveris për procedurat e centralizuara.

4. Drejtorati për Prokurime të Veçanta

Drejtorati për prokurime të Veçanta (DPV), konform nenit 21/A, pika 2 e LPP-se, ka zhvilluar aktivitetet e prokurimit për procedurat e veçanta.

Kryerja e procedurave të veçanta është bërë në pajtim me legjislacionin që rregullon çështjet e prokurimit publik në Kosovë.

Në kuadër të kontratave të veçanta në vitin 2022, AQP ka iniciuar **63 (gjashtëdhjetë e tre)** aktivitete dhe në kuadër të këtyre aktiviteteve ka nënshkruar **73 (shtatëdhjetë e tre)** kontrata në vlerë totale prej **947,704.41 €**. Vlera e parashikuar për këto 73 kontratat ishte **1,086,432.27 €**. Ndryshimi/kursimet e mundshme në mes të vlerës së parashikuar dhe vlerës totale të kontratës janë **138,727.86 €**, që i bie rreth **12.76%**.

Këto rezultate të kursimeve të mjeteve buxhetore janë arritur falë transparencës, punës profesionale që kanë treguar zyrtaret e Drejtoratit të Prokurimeve të Veçanta dhe bashkëpunimit të mirëfilltë me zyrtaret e Autoriteteve Kontraktuese për të cilat janë zhvilluar aktivitetet e prokurimit.


Vlera e parashikuar për aktivitetet e zhvilluara në bazë të nenit 21/A të LPP-së caktohet nga Agjencitë e Pavarura kur dërgojnë kërkesat e tyre në AQP për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe si rrjedhojë ka pas aktivitete të cilat janë anuluar për arsye se ofertat e pranuar kanë tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar.

Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrim të kontratave është e paraqitur në **Aneksin 2** të raportit.

DPV gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit, varësisht nga natyra apo vlera e parashikuar e kontratës, ka përdorur procedurën e hapur, kuotim të çmimit, procedurën e vlerës minimale apo procedurën e negociuar pa publikim. Kriteri i shpërblimit në të gjitha aktivitetet që është përdorur është kriteri Tenderi i përgjegjshme me çmimin më të ulët.

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT	
Lloji i Procedurës	Vlera e kontratave:
Procedurë e hapur	€ 787,124.48
Procedurë e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës	€ 8,950.00
Procedurë e kuotimit të çmimeve	€ 75,795.45
Procedurë e vlerës minimale	€ 17,641.78
Mini Tender	€ 58,193.00
Gjithsejtë	€ 947,704.71

VLERA E KONTRATAVE SIPAS LLOJEVE TË PROCEDURAVE TË
PROKURIMIT Vlera e kontratave:



Grafiku nr. 1. Vlera e kontratave sipas llojit te procedurës

5. Drejtorati për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Aktivitetet kryesore të realizuara të këtij drejtorati janë si më poshtë:

- Planifikimi i buxhetit, përgatitja e planit të rrjedhës së parasë në baza tremujore dhe mujore;
- Përgatitja dhe dorëzimi i barazimeve tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore, njëvjeçare dhe barazimi me zyrën e kontabilitetit pranë Departamentit të Thesarit/MFPT;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për burimet njerëzore, logjistikë dhe përkthyesve.
- Zhvillimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të politikave dhe procedurave standarde lidhur me buxhetin, financat, burimet njerëzore, logjistikë etj.
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i proceseve të rekrutimit dhe çështjeve lidhur me BNJ, logjistikë etj.
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e informatave për zyrën e përkthimeve.
- Përgatitja e Raportit Vjetor të Pasqyrave Financiare për AQP-në

Në baze të Ligjit nr.08 /L-143 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 08/I-066 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Agjencia Qendrore e Prokurimit, në tabelën në vijim ka prezantuar shpenzimet në totalin prej **169,338.28** Euro, nga tri (3) kategori të ndryshme ekonomike:

Kategoria: Mallra dhe shërbime /Paga dhe mëditje/Komunal	Shuma
Paga dhe mëditje Janar-Dhjetor 2022	135,417.91
Mallra dhe shërbime	32,899.12
Komunal/telefoni fikse	1,021.25
Totali	169,338.28

Siç vërehet edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme, AQP-ja nuk ka pas buxhet në kategorinë e kapitaleve dhe në të hyra, gjatë vitit raportues 2022.

Në nivel të AQP-së është ndryshuar dhe plotësuar Projekt rregullorja për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP), të cilën AQP-ja e ka përcjellë tek Ministri i MFPT-së për procedura të mëtejshme të miratimit.

6. Aktivitete tjera të zyrtarëve të AQP-së

- Konform dispozitave ligjore, kemi përgatitur Raportin Vjetor për Kontrata të nënshkruara për vitin fiskal 2022 (formën standarde të KRPP-se)
- Konform nenit 95 paragrafi 4, sipas kërkesave të disa Autoriteteve Kontraktuese, kemi dhënë mbështetje dhe këshilla në kryerjen e disa aktiviteteve të prokurimit.
- AQP kalkulon çmimin e karburanteve duke u bazuar në çmimin e berzës (S&P Global Platts) dhe e publikon në baza mujore në web faqen e AQP-së, i cili çmim përdoret për faturim nga ana e OE

7. Trajnimi

Në vitin 2022, personeli i AQP-së ndoqi programet e mëposhtme të trajnimit:

- Trajnimin “Trajnim mbi kriterin e ofertës ekonomike më të favorshme” e ndoqi një zyrtar i AQP-së, organizuar nga KRPP në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP).
- Një zyrtar ka ndjekur trajnimin për pranim të mallit në SIMFK.
- Shih Aneksin 4.

8. Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së & Rekomandimet

Çështjet që ndikojnë në efikasitetin e AQP-së

- Numri i vogël i zyrtarëve të prokurimit, kur dihet se DPC kryen aktivitetet e centralizuara dhe lista e artikujve të përbashkëta po shtohet çdo vit dhe DPV zhvillon aktivitetet e prokurimit për 16 agjenci të pavarura;
- Mos harmonizimi i planeve të prokurimit të Agjencive të Pavarura ndikon tek DPV, ku shpesh herë jemi obliguar që të zhvillojmë disa aktivitete të prokurimit për mallra apo shërbime të njëjta, por në periudha të ndryshme kohore, që konsiderohet ndarje e kërkesave;
- Hartimi jo profesional i specifikave teknike nga Agjencitë e Pavarura shkakton humbje të kohës për DPV;
- Vonesa me kthim të përgjigjeve nga ana e AK-ese si dhe kthimi i përgjigjeve jo profesionale në disa raste;
- Emërimi i personave joprofesional si anëtarë të komisionit të vlerësimit nga ana e AK-ese

Rekomandime për të përmirësuar efikasitetin e AQP-së:

- Shtimi i numrit të punëtorëve;
- Organizimi dhe financimi i punëtorëve nga AQP-ja në të cilat zyrtarët përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe zyrtarët përgjegjës të AQP-së do të marrin pjesë për të harmonizuar planet e prokurimit si dhe diskutime tjera të nevojshme.
- Hartimi i specifikimeve teknike në mënyrë profesionale dhe në përputhje me LPP nga ana e AK;
- Zyrtarët përgjegjës nga AK duhet të përgjigjen në kohë sa më të shkurtë dhe në mënyrë profesionale pasi që AQP kryen procedurat për ta dhe arritja e një kontrate të centralizuar sa më profesionale dhe në kohë do të shërbejë për të gjitha institucionet që e shfrytëzojnë atë dhe do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit të punës së tyre;
- AK-ese për anëtarë të Komisioneve të Vlerësimit të propozojnë anëtarë me njohuri profesionale mbi aktivitetet e prokurimit që zhvillohet;
- Duhet të shtohet pjesëmarrja e zyrtarëve të AQP-së, në seminare dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit në lidhje me praktikën më të mirë të prokurimit publik;


Kërkesat për vitin 2023 për përmbushjen e planeve dhe obligimeve:

- Rritja e numrit të zyrtareve të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit; Kjo për arsye se kemi numër të vogël të stafit si në DPC ashtu edhe në DSHV
- Shtimi i fondeve për trajnime dhe për mbulimin e shpenzimeve për angazhimin e ekspertëve në hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike;
- Organizimi dhe financimi nga AQP-ja i një punëtorie (në të cilin do të marrin pjesë Zyrtaret Përgjegjës të Agjencive të Pavarura dhe Zyrtaret Përgjegjës të AQP-se për harmonizimin e planeve përfundimtare të prokurimit për vitin fiskal 2023;
- Organizimi i dy punëtorive, një me zyrtarë të nivelit qendror dhe tjetra me zyrtarë të nivelit lokal për harmonizimin e kërkesave dhe qëllimeve dhe për uniformimin e dokumenteve për paraqitjen e kërkesave dhe specifikimeve teknike;
- Kërkohej disiplinë dhe përgjegjësi e njësisë kërkuese përkatësisht e Autoriteteve kontraktuese në ofrimin e shënimeve dhe specifikimeve teknike për aktivitetet e prokurimit që duhet të zhvillojë AQP-ja;
- Kërkohej që Autoritetet Kontraktuese që dërgojnë kërkesa për zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit në AQP që specifikat teknike të hartojnë në mënyrë profesionale dhe në harmoni me depozitat e LPP;
- Kërkohej që Autoritetet Kontraktuese për të cilat zhvillohen aktivitetet e prokurimit për pjesëmarrje në komisione të vlerësimit të ofertave të propozojnë anëtarë që kanë njohuri lidhur me mallrat, shërbimet, punët, që prokurohen;
- Të jepet mundësia që Zyrtaret e prokurimit të AQP-se të dërgohen në seminare dhe trajnime në vende dhe jashtë vendit që ligjërohen tema nga zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit sipas Rregulloreve dhe legjislacionit evropian.
- Të respektohen nga institucionet publike afatet kohore të vendosura nga AQP-ja për kthimin e përgjigjeve.

Arsyetim

- Përkrahja institucionale, financiare dhe kadrovike e AQP-së do të rezultojë me kursime milionëshe, me kursim të kohës dhe mjeteve për AK.
- Po është e pritshme edhe përzgjedhja e kompanive serioze me ç'rast pritet të sigurohet furnizime dhe shërbime më cilësore dhe çka është më e rëndësishmja të gjitha institucionet publike që shfrytëzojnë kontratat e centralizuara marrin produkte dhe shërbime të njëjta, pra kontratat e centralizuara standardizojnë produktet dhe shërbimet.
- AQP gjatë punës së vet do të angazhojë edhe zyrtarë nga AK të nivelit lokal dhe qendror të cilët mund të fitojnë përvoja në punë ekipore në vlerësimin e projekteve me vlera të mëdha.
- Një AQP e përkrahur do të jetë një histori suksesi për Ministrinë e Financave dhe për AK duke siguruar kontrata të dobishme dhe duke përmbushur arsyen e ekzistimit të saj

Aneksi 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE



Aneksi 2. Lista e aktiviteteve të prokurimit që kanë përfunduar me nënshkrimin e kontratave nga DPV

<i>Nr. rendor</i>	<i>Numri i prokurimit</i>	<i>Titulli i Kontratës</i>	<i>Data e nënshkrimit të kontraktues</i>	<i>Vlera e parashikuar ne €</i>	<i>Vlera e kontraktuar ne €</i>	<i>Ndryshimet</i>
1	UA/2016-21-8391-2-2-1	Shërbime të Auditimit të Brendshëm të Teknologjisë Informative të FKPK-së	19.01.2022	24000.00	14500.00	9500.00
2	UA/2016-21-10125-2-2-1	Shërbimet e sigurimit fiduciar për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës-Ritender	28.01.2022	40000.00	39880.00	120.00
3	UA/2016-21-9871-2-2-1	Shërbimet e sigurimit shëndetësor për nevojat e Fondit për Kursime Pensionale te Kosovës	28.01.2022	11500.00	9016.80	2483.20
4	UA/2016-21-10515-2-3-6	Mirembajtja e Web Faqës së OSHP-së	29.03.2022	5000.00	4140.00	860.00
5	UA/2016-22-724-1-4-7	Furnizim me pajisje për regjistrim monitorim të prezencës në punë	16.02.2022	800.00	729.20	70.80
6	UA/2016-22-1041-5-5-8	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	09.05.2022	39500.00	36644.00	2856.00
7	UA/2016-22-256-2-3-6	Qasja dhe shfrytëzimi i platformës ZOOM për Video komunikim për Nevojat e Akademisë së Drejtësisë	25.02.2022	3000.00	3000.00	0.00
8	UA/2016-22-1123-1-4-7	Furnizim me fasiklla për nevojat e KPSHCK	25.02.2022	997.50	957.60	39.90
9	UA/2016-22-807-2-3-5	Ri-konfigurimi i Serverëve si dhe të pajisjeve të rrjetit	14.03.2022	9800.00	8950.00	850.00
10	UA/2016-22-1903-1-4-7	Furnizim me foli akull për nevojat e zyrave të ZRRE-së	18.03.2022	950.00	677.61	272.39
11	UA/2016-22-1372-2-3-6	Sigurimi i automjeteve për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore	21.03.2022	3500.00	2581.70	918.30

12	UA/2016-22-2379-1-4-7	Furnizim me perde rrotulluese dhe tapetë për mur për nevojat e ZRRE-së	30.03.2022	990.00	960.07	29.93
13	UA/2016-22-2536-1-4-7	Furnizimi dhe Instalimi i pjesëve (ATS) Gjeneratorit	31.03.2022	990.00	982.60	7.40
14	UA/2016-22-2733-1-4-7	Furnizim me foli akull për nevojat e zyrave të ZRRE-së	06.04.2022	950.00	919.12	30.88
15	UA/2016-22-3118-1-4-7	Furnizim me Fasiklla varëse për nevojat e Agjencisë Kunder Korrupsion	18.04.2022	999.00	840.00	159.00
16	UA/2016-22-1816-2-3-6	Servisim dhe Mirëmbajtje për veturen zyrtare Audi për nevojat e ARRU-së	20.04.2022	3000.00	3000.00	0.00
17	UA/2016-22-3227-1-4-7	Furnizim me material zyrtare për nevojat e Fondit për Sigurim Shëndetësor.	21.04.2022	990.00	508.00	482.00
18	UA/2016-21-8388-2-1-1	Mirëmbajtja e Platformës së e-Prokurimit për nevojat e KRPP-së -Ritender	28.04.2022	300000.00	299961.90	38.10
19	UA/2016-22-1457-2-2-1	Sigurimi fizik i objektit të Fondi i Sigurimit Shëndetësor (FSSH)	02.05.2022	38000.00	30585.60	7414.40
20	UA/2016-22-4348-2-4-7	Vendosjen e sistemit të alarmit të kompletuar për sigurinë e pasurisë në objektin e ANJF-së	18.05.2022	600.00	499.92	100.08
21	UA/2016-22-4500-5-5-8	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	28.06.2022	2997.00	2175.00	822.00
22	UA/2016-22-1907-1-2-1	Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnit për nevojat e Agjencive të Pavarura	17.05.2022	57077.77	35481.21	21596.56
23	UA/2016-22-1907-1-2-1	Furnizim me materiale të shtypura dhe shërbimet e dizajnit për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	17.05.2022	50000.00	19488.80	30511.20
24	UA/2016-22-3541-1-3-6	Furnizim me klima për nevojat e Agjencive të Pavarura	31.05.2022	3650.00	2900.00	750.00
25	UA/2016-22-3655-1-4-7	Furnizimi dhe montimi i kontraktorit të gjeneratorit (pjesa elektrike)	30.05.2022	900.00	870.00	30.00
26	UA/2016-22-3484-1-3-6	Furnizim me material higjienik dhe produkte tjera higjienike për nevojat e Agjencive të Pavarura Ritender	01.06.2022	8880.00	4775.00	4105.00

27	UA/2016-22-5130-1-4-7	Furnizim me internet per 4 pikat e stacioneve fikse monitoruese dhe në zyrat e ARKEP-it lidhur me projektin NSMS	01.06.2022	990.00	985.00	5.00
28	UA/2016-22-3994-1-3-6	Furnizim me letër për kopje për nevojat e Agjencive të Pavarura	31.05.2022	4369.00	4343.00	26.00
29	UA/2016-22-3950-1-3-6	Furnizim me telefona për zyre për nevojat e Agjencisë Kundër Korrupsionit	07.06.2022	2000.00	980.00	1020.00
30	UA/2016-22-5242-2-4-7	Servisimi i pajisjeve të TI-së për nevojat e Akademisë së Drejtësisë	06.06.2022	990.00	980.00	10.00
31	UA/2016-22-1805-1-1-1	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës dhe Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	23.06.2022	3220.00	2635.00	585.00
32	UA/2016-22-1805-1-1-1	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Fondit për Kursimet Pensionale të Kosovës	23.06.2022	3100.00	2445.00	655.00
33	UA/2016-22-1805-1-1-1	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Agjencia Kundër Korrupsionit	23.06.2022	9999.00	8216.00	1783.00
34	UA/2016-22-1805-1-1-1	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	23.06.2022	75000.00	73250.00	1750.00
35	UA/2016-22-1805-1-1-1	Furnizim me softwer për Fondit i Kursimet Pensionale të Kosovës	23.06.2022	9200.00	9195.00	5.00
36	UA/2016-22-1805-1-1-1	Furnizim me pajisje të TI-së për nevojat e Zyra e Rregullatorit për Energji	23.06.2022	70800.00	70259.60	540.40
37	UA/2016-22-5301-2-3-6	Hulumtimi i Opinionit të konsumatorëve lidhur me kënaqshmërinë me shërbimet e ujit në Kosovë	11.07.2022	6000.00	3490.00	2510.00
38	UA/2016-22-7487-1-4-7	Furnizim me frigorifer për zyre për nevojat e AIP	27.07.2022	550.00	540.00	10.00
39	UA/2016-22-5848-1-3-6	Furnizim me material zyrtar për nevojat e Agjencive të Pavarura	01.08.2022	6819.00	4929.95	1889.05
40	UA/2016-22-5770-2-2-1	Zhvendosja (bartja) e inventarit të Akademisë së Drejtësisë në objekt të ri	04.08.2022	15000.00	8733.33	6266.67

41	UA/2016-22-7529-2-3-6	Servisim dhe mirëmbajtje të veturës Mazda, për nevojat Zyrtare te ARRU-së	25.08.2022	3000.00	3000.00	0.00
42	UA/2016-22-8728-1-4-7	Furnizim me tetëmbëdhjete (18) UPS për nevojat e KPMSHCK.	25.08.2022	990.00	553.86	436.14
43	UA/2016-22-9425-5-5-8	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	18.10.2022	5750.00	3434.00	2316.00
44	UA/2016-22-9282-2-4-7	Angazhimi i një experti për konservimin e mozaikut për nevojat e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.	08.09.2022	700.00	700.00	0.00
45	UA/2016-22-9517-2-4-7	Mirëmbajtja dhe instalim i pajisjeve të Teknologjisë Informative, ripërtëritje e certifikatave dhe ueb hosting -ut për domenin e ZRrE -së	13.09.2022	999.00	995.00	4.00
46	UA/2016-22-9433-1-4-7	Furnizim me bateri për 30 UPS për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.	12.09.2022	600.00	343.50	256.50
47	UA/2016-22-8939-2-3-6	Ofrimi i shërbimeve sekondare dytësore të internetit për nevojat e ZRRE-së.	26.09.2022	7500.00	2655.00	4845.00
48	UA/2016-22-7996-2-2-1	Shërbime të mirëmbajtjes higjienike dhe teknike të Objektit të FSSH-së	29.09.2022	13000.00	9119.64	3880.36
49	UA/2016-22-9044-2-2-1	Sigurimi i automjeteve për Agjencitë e Pavarura-Ritender	29.09.2022	35240.00	33907.10	1332.90
50	UA/2016-22-10886-5-5-8	Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative	17.11.2022	16900.00	15940.00	960.00
51	UA/2016-22-10867-1-4-7	Furnizim me ujë të xhamave për veturat e Komisionit të Pavarur për Media	10.10.2022	400.00	260.00	140.00
52	UA/2016-22-9369-2-3-6	Shërbimet e kursit të gjuhës angleze për nevojat e Agjencisë për Informim dhe Privatësi	10.10.2022	5000.00	4890.00	110.00
53	UA/2016-22-10876-2-4-7	Servisimi komplet i gjeneratorit për nevojat e Komisionit të Pavarur të Mediave	12.10.2022	700.00	700.00	0.00
54	UA/2016-22-10947-2-4-7	Spote publicitare për nevojat e Autoritetit të Aviacionit Civil	12.10.2022	990.00	989.00	1.00
55	UA/2016-22-11047-1-4-7	Furnizim me tapeta muri me foto të ndryshme për nevojat e Autoritetit të Aviacionit Civil	13.10.2022	990.00	990.00	0.00
56	UA/2016-22-9519-2-3-6	Sall për trajnime dhe konferenca për nevojat e AAC-së	21.10.2022	2860.00	2848.00	12.00

57	UA/2016-22-9643-2-2-1	Sigurimi dhe monitorimi 24 7 i tri pikave të stacioneve fikse në kuader të projektit Sistemin Nacional të Monitorimit të Spektrit (SNMS) për ARKEP-in.	25.10.2022	49500.00	45360.00	4140.00
58	UA/2016-22-10884-2-3-6	Ofrimi i shërbimeve sekondare të internetit për nevojat e Agjencive të Pavarura	08.11.2022	7300.00	4014.00	3286.00
59	UA/2016-22-10813-2-3-6	Ngjyrosja e veturave zyrtare për nevojat e ARRU	10.11.2022	2000.00	1870.00	130.00
60	UA/2016-22-12390-2-4-7	Servisimi komplet i gjeneratorit për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	23.11.2022	720.00	671.00	49.00
61	UA/2016-22-10828-1-3-6	Furnizim me pajisje të TI (kufje, USB, kamera për PC) për nevojat e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës	10.11.2022	1230.00	482.00	748.00
62	UA/2016-22-13010-2-4-7	Servisimi i rregullt i sistemeve të shuarjes automatike të zjarrit dhe sistemeve të Aspirimit për lajmërim të zjarrit në dhomën e Serverit dhe Arkivës	18.11.2022	990.00	990.00	0.00
63	UA/2016-22-10766-1-2-1	Lot II -Furnizim me Licenca për Oracle Database 19c Standard Edition	22.11.2022	29000.00	28500.00	500.00
64	UA/2016-22-10766-1-2-1	Lot III -Furnizim me WildCard SSL	22.11.2022	1800.00	1655.00	145.00
65	UA/2016-22-11472-1-3-6	Furnizim me Internet për 4 pikat e Stacioneve Fikse Monitoruese lidhur me Projektin NSMS dhe Qendrën Kryesore Monitoruese në zyrat e ARKEP-it.	22.11.2022	7000.00	6948.00	52.00
66	UA/2016-22-11061-1-2-1	Furnizim me inventar për nevojat e Organit Shqyrtues të Prokurimit	28.11.2022	8000.00	6220.00	1780.00
67	UA/2016-22-11061-1-2-1	Furnizim me karrige për nevojat e Agjencive të Pavarura	28.11.2022	11796.00	10930.00	866.00
68	UA/2016-22-11062-1-3-6	Furnizim me UPS-es për nevojat e Agjencis për Parandalimin e Korrupsionit	24.11.2022	5000.00	4256.80	743.20
69	UA/2016-22-21-1-3-6	Angazhimi i përmbaruesve privat për nevojat e Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare-Ritender	31.05.2022	5000.00	4369.00	631.00
70	UA/2016-22-11764-2-3-6	Sigurimi i Pajisjeve të Monitorimit për KPM	26.11.2022	2000.00	1980.00	20.00

71	UA/2016-22-3994-2-3-6	Furnizim me letër për kopje për nevojat e Agjencive të Pavarura	31.05.2022	4369.00	4343.00	26.00
72	UA/2016-22-10844-2-2-1	Shërbime për test depërtimi (Penetration Test) për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	12.12.2022	15000.00	7950.00	7050.00
73	UA/2016-22-13287-1-2-1	Furnizim me disa licenca renovim vazhdim të softuerëve ekzistues për nevojat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës	16.12.2022	23000.00	19834.50	3165.50
			Total:	1086432.27	947704.41	138727.86

Aneksi 3. LISTA E KONTRATAVE TE CENRALIZUARA NE FUQI

Në tabelën e mëposhtëm janë paraqitur vetëm titujt e kontratave të cilat kanë qenë aktive gjatë vitit 2022 pra duke përfshirë kontratat e nënshkruara në vitet paraprake por që kanë qenë aktive edhe gjatë vitit 2022, dhe kontratat e nënshkruara në vitin 2022. Të gjitha të dhënat tjera për këto kontrata mund të gjenden në web faqen e AQP-së ku këto kontrata janë të publikuara, për më shumë vizitoni linkun <https://aqp.rks-gov.net/kontratat-e-centralizuara/>

Nr.	Titulli i Kontratave ³
1.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira Niveli lokal LOT I
2.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira Niveli Lokal Lot II
3.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira Niveli lokal LOT III
4.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira Niveli lokal LOT IV
5.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira Niveli lokal LOT V
6.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira Niveli lokal Lot VI
7.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printereve me qira Niveli Qendror Lot 1
8.	Kontrata – Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printereve me qira Niveli Qendror Lot 2
9.	Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 1 lot 1 dhe 2
10.	Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 2 lot 1 dhe 2
11.	Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 3 lot 1
12.	Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 3 lot 2
13.	Aneks kontratë Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 1
14.	Aneks kontratë Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 2
15.	Aneks kontratë Shfrytëzimi i automjeteve me qira – kategoria 3
16.	Kontrate Kornizë Furnizim me goma për automjete Lot 1 Bibaj AE
17.	Kontrate Kornizë Furnizim me goma për automjete Lot 2 Eurogoma
18.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime – Grup i Operatorëve Ekonomik Korabi – Company Sh.p.k; T&A COMPANY SH.P.K
19.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime - Grup i Operatorëve Ekonomik N.N.SH. SKAND – IN; DONI PRUDUCT SH.P.K.
20.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime – “EXIM” SH.P.K.
21.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime – Beni Dona Plast SH.P.K
22.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime - Grup i Operatorëve Ekonomik BRAHIM ZEQRIRI B.I; ADA GROUP SH.A.
23.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime - Grup i Operatorëve Ekonomik ENZO SH.P.K; N.T.P HAJDINI COMERC.
24.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime - Grup i Operatorëve Ekonomik “Onix1” SH.P.K; “Adriatiku” Sh.p.k.
25.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime – N.P.T. “Fatosi-Com”

³ Të gjitha kontrata janë publike dhe mund të shkarkohen nga web faqja e AQP-së <https://aqp.rks-gov.net/kontratat-e-centralizuara/>

Nr.	Titulli i Kontratave ³
26.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime - Grup i Operatorëve Ekonomik N.P.T. Florenti; AS-1 GROUP SH.P.K.
27.	Marrëveshja publike kornize Furnizim me peme dhe perime – “RINESA 1” SH.P.K.
28.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - InfoSoft Systems SH.P.K.
29.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative - ARITECH
30.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Botek shpk
31.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - InterAdria L.L.C.
32.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik KOSOVA INFORMATION TECHNOLOGY SH.A.; PROMPT INTERNATIONAL SH.P.K.
33.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik INFINITT SH.P.K.; N.T.P. VLORA ; First Solution L.L.C.; Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi ; FutureBITS SH.P.K.
34.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik: " ILIR - KOSOVA " SH.P.K.; Comtrade Computers O.K.
35.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik AXA SH.P.K.; TMS MOBILE SH.P.K.
36.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - N.T.SH. Virtuo
37.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik N.SH. TECH VISION ; Mehmet Sahitolli B.I.; N.T.SH. NORD
38.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - " NOVUS " SH.P.K.
39.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik PBC SH.P.K.; S.D.S SOFTWARE DEVELOPMENT SOLUTION SH.P.K.
40.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje te Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik: " Safebit " L.L.C.; "STORM ICT" L.L.C.
41.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik TRIO TEK SH.P.K.; N.T.SH. ARTECH ; N.T.P ERAMED
42.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - " Cactus " Sh.a.
43.	Marrëveshja publike kornize – Furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative - Grup i Operatorëve Ekonomik EUROPRINTY; P.C. COMP
44.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT I – Niveli Lokal2020
45.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT II– Niveli Lokal 2020
46.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT III– Niveli Lokal 2020
47.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT IV– Niveli Lokal 2022

Nr.	Titulli i Kontratave ³
48.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT VI– Nivelit Lokal 2021
49.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT I – Nivelit Qendror 2019
50.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT II – Nivelit Qendror 2019
51.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT III– Nivelit Qendror 2019
52.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT IV – Nivelit Qendror 2019
53.	Furnizim me karburante (benzin dizell) LOT V – Nivelit Qendror 2019
54.	Kontrata – Furnizimi me letër Nivelit Lokal- Lot 3 2022
55.	Furnizimi me letër – Kontrate kornizë – Lot 4 Nivelit Lokal- Regjioni Ferizaj 2020
56.	Furnizimi me letër – Kontrata kornizë – Lot 5 – Nivelit Lokal -Regjioni i Gjilanit 2020
57.	Furnizimi me Letër -Kontrate kornizë – Nivelit Lokal Lot 2 2020
58.	Furnizim me letër -Kontrate kornizë – Lot 1 – Nivelit Lokal 2020
59.	Furnizimi me letër- Kontrate kornizë – Lot 6 – Nivelit Lokal 2020
60.	Kontratë Kornizë – FURNIZIMI ME VETURA PER INSTITUCIONET E REPUBLIKES SE KOSOVS – Lot 1 2020
61.	Kontratë Kornizë – FURNIZIMI ME VETURA PER INSTITUCIONET E REPUBLIKES SE KOSOVS – Lot 2 2020
62.	Kontratë Kornizë – FURNIZIMI ME VETURA PER INSTITUCIONET E REPUBLIKES SE KOSOVS – Lot 3 2020
63.	Kontratë Kornizë – FURNIZIMI ME VETURA PER INSTITUCIONET E REPUBLIKES SE KOSOVS – Lot 4 2020
64.	Kontratë kornizë – Lot 2 Furnizimi me material shpenzues zyrtar 2020
65.	Kontratë kornizë – Lot 4 Furnizimi me material shpenzues zyrtar 2020
66.	Shërbime të transportit ajror 2021
67.	Furnizim me Inventar Zyrtar – Lot 3 2021
68.	Furnizim me Inventar Zyrtar – Lot 1 2021
69.	Lot 1 - Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës 2022
70.	Lot 2 - Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror 2022
71.	Lot 4 - Furnizim me karburante për nxehmje gjenerator për nevojat e institucioneve të Nivelit Qendror 2022
72.	FURNIZIMI ME GOMA DIMËRORE PËR AUTOMJETE 2022
73.	Furnizim me karburante – Nivelit Qendror - Furnizim me karburante për nevojat e FSK-së - Ritender 2022
74.	Furnizim me letër për kopje 2022
75.	Shërbime të Transportit Ajror - Ritender 2022
76.	Furnizim me MAZUT Nivel Qendror dhe Lokal Ri-Tender 2022
77.	Furnizim me ujë të pijes 2022

Nr.	Titulli i Kontratave ³
78.	Furnizim me karburante për Rajonin e Gjilanit - Niveli Lokal 2022
79.	FURNIZIMI ME GOMA PËR AUTOMJETE - NIVELI QENDROR 2022
80.	Lot 1 - Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit 2022
81.	Lot 2 - Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës 2022
82.	Lot 3 - Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit 2022
83.	Lot 4 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor 2022
84.	Lot 5 - Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor 2022
85.	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera – Niveli Qendror - Ritender 2022

Aneksi 4. TABELA E PJESEMARRSVE NE TRAJNIME

Trajnim mbi kriterin e ofertës ekonomike më të favorshme		
Emri dhe mbiemri	Pozita	Email
1. Luljeta Lokaj	Zyrtare e Lartë e Prokurimit	luljeta.lokaj@rks-gov.net
Programi themelor-bazik i prokurimit ⁴		
Emri dhe mbiemri	Pozita	Email
1. Simon Rrapi	Zyrtar i Logjistikes	simon.rrapi@rks-gov.net

⁴ <https://e-prokurimi.rks-gov.net/Home/ClanakItemNew.aspx?id=346>